



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**Komuna e Kaçanikut**  
Opština Kacanik  
Municipal off Kacanik

01Nr. 08-400-2290/16  
Kaçanik, 27.01.2016

Në bazë të nenit 17 (c) të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale, të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës, të nenit 6.2 dhe 61.1 të Statutit të Komunës, të nenit 5 lidhur me nenin 17 alinea 2 e Rregullores 01Nr. 16- 27192/12-Për Përcaktimin e Kritereve për Ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve, të Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 05-400-28468/15 të Buxhetit të Komunës për vitin 2016, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me datë 27.01.2016, mori këtë:

### V E N D I M

#### **PËR DESTINIMIN E MJETEVE FINANCIARE PËR REALIZIMIN E PROJEKTEVE TË DREJTORISË SË BUJQËSISË SË BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE PYLLTARISË, SHPËNDAHET PËR KËTO PROJEKTE**

1. Me këtë Vendim, buxheti i lejuar për vitin 2016 nga mjetet e Subvencioneve dhe Transfereve në shumë **60.000 €** (Gjashtëdhjetëmijë euro) me destinim për realizimin e projekteve të drejtorisë së Bujqësisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë, shpëndahehet për këto projekte:

1.1. Projekti për mbështetje të fermerëve me fidane të mjedrës, shuma e mjeteve, **21,600.00 €**;

1.2. Projekti për mbështetje të bletarëve me shoqëri bletësh, vlera e projektit, **19,500.00 €**;

1.3. Projekti për subvencionimin e fermerëve me farë gruri dhe pleh mineral, shuma e mjeteve, **18,900.00 €**.

2. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen : drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë dhe drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit.

3. Obligohet drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë t'i merr veprimet e nevojshme për implementimin e projekteve, sipas projekteve të detajuara të cilat gjenden në këtë drejtori.

4. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të autoritetit mbikqyrës-MAPL si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

#### **Me këtë Vendim njoftohen:**

1. Kryetari i Komunës;
2. Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë;
3. Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit; dhe
4. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit  
**Xhevat Gashi**